

'SPECIALJA KA SHKELUR KUSHTETUTËN DHE TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE'

FAQE 3

LIRIA KA EMËR



Platforma “Lira ka emër” ka organizuar të hënën një konferencë në të cilën është diskutuar për punën e Gjykatës Speciale. Akademik Arsim Bajrami ka kritikuar ashpër këtë gjykatë, duke e akuzuar për shkelje të Kushtetutës së Kosovës, të drejtave themelore të njeriut dhe për komplot ndaj luftës çlirimtare të UÇK-së. Bajrami e ka cilësuar Specialen “derivat i një raporti të rremë dhe të fabrikuar nga Dick Marty” që, sipas tij, është sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia. Ndërsa profesori universitar i të Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë se akuzat ndaj liderëve të UÇK-së, Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, shkaktojnë pasoja jo vetëm për luftën e drejtë të UÇK-së, por edhe për Kosovën, pavarësia e së cilës është e njohur nga më shumë se 100 shtete

AKTUALE



APELI I SPECIALES IA UL DËNIMIN PJETËR SHALËS NË 13 VJET BURGIM

F. 3

KRIZA NË KUVEND DHE TË DREJTAT E SERBËVE, TEMAT E DISKUTIMIT NË MES TË HANRAHANIT DHE POLITIKANËVE

F. 5

RASTI ‘VETERANËT’, DHJETË TË AKUZUAR DËNOHEN ME NGA NJË VIT BURGIM, DY TË TJERË LIROHEN

F. 6

EKONOMI



OEK-u: KOMERCIALJA PEZULLON VENDIMIN E ZRRE-së PËR DALJEN NË TREGUN E LIRË TË ENERGJISË PËR PESË KOMPANI

F. 8

882 MILIONË EURO TË BLOKUARA PËR SHKAK TË MOSKONSTITUIMIT TË KUVENDIT

F. 8

DEPUTETI GJERMAN: KOSOVA DUHET TË BËHET ANËTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS

F. 7



GRENELLI E AKUZON OSMANIN PËR ‘MANIPULIM TË FJALËVE’ TË TRUMPIT

F. 5



SPORT



CHELSEA SHPALLET KAMPIONE E BOTËS

F. 10

RENOVA

PUTZ

Maqedoni

Xhepçisht –Tetovë

Gurëz-Ferizaj

Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009

+389 44 487 755

Fax: +389 44 487 200

Mob: +377 44 501 289

E-mail: renova@mt.net.mk



NDËRTIM

PROJEKTIM

SHITJE

INFO: 049-111-101,

044-511-177

www.princesha-ks.com



Bunjamini

FABRIKA E LLAQEVE

044/256-051

044/367-061

028/532-617

MITROVICË

STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË



Kolegji BIZNESI

www.kolegjbiznesi.com

info@kolegjbiznesi.com

030 500 878 | 045 500 878

044 500 878 | 049 500 878



SIGMA

VIENNA INSURANCE GROUP

SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A

DEGA KOSOVË

Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,

Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,

E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net



INFINITY

Digital Agency

Endrit Shaqiri

+38344685122

Internet Website,

Marketing...

Trumpi ia jep Ukrainës sistemet ‘Patriot’, BE-ja paguan

Uashington, 14 korrik - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) pritet ta furnizojnë Ukrainën me raketat “Patriot”, urgjentisht të nevojshme për mbrojtjen nga dronët rusë. Presidenti amerikan, Donald Trump, ka njoftuar se sistemet e mbrojtjes do të paguhen nga Bashkimi Evropian (BE). “Ne do t’u dërgojmë atyre ‘Patriotët’, për të cilat ata kanë nevojë urgjentisht”, ka thënë Trumpi. Megjithatë në bazën ajrore Andrews para gazetarëve, ai e la të hapur numrin e saktë të sistemeve që do të dërgonte, por ka thënë se do jenë disa. “Armët do të financohen nga BE-ja. Populli i Ukrainës ka nevojë për mbrojtjen e ‘Patriotëve’, por Bashkimi Evropian po paguan për këtë. Ne nuk po paguajmë asgjë. Është marrëveshje biznesi”, ka thënë Trumpi.

Duke iu referuar një takimi të ardhshëm me sekretarin e përgjithshëm të NATO-s, Mark Rutte, presidenti Trump ka thënë se aleanca transatlantike e mbrojtjes do të blejë teknologji ushtarake amerikane. “Ne në thelb do t’u dërgojmë atyre pjesë të ndryshme të pajisjeve të sofistikuara ushtarake dhe ata do të na paguajnë 100 për qind për këtë”, ka thënë Trumpi, i cili planifikon të takohet me Rutte këtë javë për të diskutuar mbi

Ukrainën dhe çështje të tjera, raporton “DW”.

Sistemet e mbrojtjes raketore nevojiten me urgjencë

Ukraina i ka kërkuar ShBA-së t’i shesë më shumë raketa dhe sisteme “Patriot”, të cilat i konsideron me rëndësi thelbësore për mbrojtjen e qyteteve të saj kundër sulmeve ajrore ruse. Që nga fillimi i muajit, Rusia ka intensifikuar më tej intensitetin e sulmeve, veçanërisht kundër qyteteve në Ukrainë. Më 4 korrik, presidenti ukrainas, Volodymyr Zelensky, ka folur për sulmet më të dhunshme që nga fillimi i luftës, sipas tij ushtria ruse ka sulmuar me rreth 540 dronë. Që atëherë, kanë pasuar sulme të tjera ruse, duke përfshirë qindra dronë. Gjatë fundjavës janë raportuar vdekje të tjera dhe më shumë se dhjetë të plagosur si pasojë e sulmeve ruse.

Gjermania merr pjesë në furnizimin me raketa “Patriot”

Sistemet “Patriot” të përmendur nga Trumpi mund të jenë sistemet e përmendura të enjten e kaluar në konferencën e rindërtimit mbi



Ukrainën në Romë. Kancelari Friedrich Merz, ka njoftuar publikisht atje për herë të parë se do të blinte sisteme të mbrojtjes ajrore “Patriot” nga ShBA-ja për t’i dërguar ato në Ukrainë. Atje, mund të përfshihen dy sisteme dhe një tjetër mund të paguhet nga Norvegjia. Deri më tani, Ukraina ka marrë tre sisteme “Patriot” nga Gjermania, të cilat ishin pjesë e Bundeswehr-it. Kujtojmë se Trumpi kishte pezulluar furnizimet me armë

në Ukrainë, por më pas është tërhequr nga ky vendim. Të hënën e kaluar, ai ka njoftuar për furnizime shtesë me armë në Ukrainë, por pa dhënë detaje. Shtetet e Bashkuara kanë qenë një nga mbështetësit më të mëdhenj të Ukrainës që nga fillimi i luftës në Ukrainë, kur demokrati Joe Biden ishte ende president i ShBA-së. Edhe nën pasardhësin e tij, Trumpi, ShBA-ja ka mbetur furnizuesi më i rëndësishëm me armë i Ukrainës. Megjithatë, pasi

Trumpi është kthyer në Shtëpinë e Bardhë në janar, Shtetet e Bashkuara janë afruar me Rusinë, duke përfshirë edhe nisjen e bisedimeve të drejtpërdrejta midis përfaqësuesve. Gjatë fushatës së tij zgjedhore, Trumpi kishte premtuar t’i jepte fund luftës menjëherë pas marrjes së detyrës si president. Por kanë kaluar pesë muaj që atëherë dhe lufta vazhdon të shpërthejë me intensitet edhe më të madh.

BE-ja, gati t’i vendosë tarifa ShBA-së nëse s’ka marrëveshje

BRUKSEL, 14 KORRIK - Bashkimi Evropian (BE) ka përgatitur një listë tarifash - në vlerë prej 21 miliardë eurosh - për mallrat amerikane, nëse dy palët nuk arrijnë marrëveshje tregtare, ka thënë ministri i Jashtëm i Italisë, Antonio Tajani.

Presidenti amerikan, Donald Trump, ka paralajmëruar se do të vendosë tarifa prej 30 për qind për importet nga Meksika dhe Bashkimi Evropian (BE), nisur nga 1 gushti, pasi negociatat disajvore me partnerët kryesorë tregtarë të ShBA-së kanë dështuar të sjellin marrëveshje.

Duke folur për gazetën Il Messaggero, Tajani ka thënë gjithashtu se, për të ndihmuar ekonominë e Eurozonës, Banka Qendrore Evropiane duhet të shqyrtojë një program të ri për blerjen e bonove dhe ulje të reja të normave të interesit.

Nga Bashkimi Evropian (BE) kanë thënë se do të shtyjë



marrjen e masave hakmarrëse kundër ShBA-së deri në fillim të gushtit, me shpresën se do të arrihet një marrëveshje përmes negociatave.

Tajani ka thënë se paketa prej 21 miliardë eurosh tarifa, që BE-ja ka përgatitur, mund të pasohet me një rund të dytë masash, nëse nuk ka marrëveshje me

ShBA-në. Megjithatë, ai ka thënë se beson se mund të ketë përparim në negociata. “Tarifat i dëmtojnë të gjithë,

duke filluar nga Shtetet e Bashkuara. Nëse tregjet e aksioneve bien, një gjë e tillë do t’i vinte në rrezik pensionet dhe kursimet e amerikanëve”, ka thënë Tajani.

Sipas tij, qëllimi duhet të jetë “zero tarifa” dhe një treg i hapur mes Kanadasë, Shteteve të Bashkuara, Meksikës dhe Evropës.

Kancelari gjerman, Friedrich Merz, ka thënë të dielën se do të punojë në mënyrë intensive me presidentin francez, Emmanuel Macron, dhe presidenten e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, për të zgjidhur konfliktin tregtar me Shtetet e Bashkuara.

Te konflikti i tillë vjen kur dy ose më shumë vende vendosin tarifa ose barriera të tjera tregtare ndaj mallrave dhe shërbimeve që importohen nga njëri-tjetri, për të mbrojtur prodhimet vendore ose për të fituar avantazh ekonomik.

‘SPECIALJA KA SHKELUR KUSHTETUTËN DHE TË DREJTËN NDËRKOMBËTARE’

Platforma “Lira ka emër” ka organizuar të hënën një konferencë në të cilën është diskutuar për punën e Gjykatës Speciale. Akademik Arsim Bajrami ka kritikuar ashpër këtë gjykatë, duke e akuzuar për shkelje të Kushtetutës së Kosovës, të drejtave themelore të njeriut dhe për komplot ndaj luftës çlirimtare të UÇK-së. Bajrami e ka cilësuar Specialen “derivat i një raporti të rremë dhe të fabrikuar nga Dick Marty” që, sipas tij, është sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia. Ndërsa profesori universitar i të Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë se akuzat ndaj liderëve të UÇK-së, Thaçit, Veselit, Selimit dhe Krasniqit, shkaktojnë pasoja jo vetëm për luftën e drejtë të UÇK-së, por edhe për Kosovën, pavarësia e së cilës është e njohur nga më shumë se 100 shtete

EPOKA
ERE

Lirim GECI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Në konferencën e organizuar nga platforma “Lira ka emër”, akademik Arsim Bajrami ka kritikuar Gjykatën Speciale, duke e akuzuar për shkelje të Kushtetutës së Kosovës, të drejtave themelore të njeriut dhe për komplot ndaj luftës çlirimtare të UÇK-së. Bajrami e ka cilësuar këtë gjykatë “derivat i një raporti të rremë dhe të fabrikuar nga Dick Marty” që, sipas tij, është sponsorizuar nga Rusia dhe Serbia. Ai ka thënë se përmes këtij procesi

po tentohet të rishkruhet historia moderne e Kosovës dhe të inkriminohet padrejtësisht lufta çlirimtare. “Gjykata Speciale është një projekt i montuar politikisht për ta shtrembëruar të vërtetën historike të luftës sonë çlirimtare. Ajo është ndërtuar mbi një mashtrim ordiner të Raportit të Martyt dhe për këtë heshtja e Këshillit të Evropës është bashkëfajësi e pastër”, ka thënë Bajrami. Ai ka kritikuar ashpër edhe institucionet e Kosovës, duke i konsideruar të dështuara në mbrojtjen e luftës çlirimtare dhe të qytetarëve që po

përballen me këtë proces gjyqësor. “Kuvendi e formoi Gjykatën Speciale me mirëbesim për drejtësi, por ajo tani është shndërruar në një gjykatë monoetnike e diskriminuese, që bashkëpunon më shumë me Serbinë sesa me autoritetet e Kosovës”, ka thënë ai. Bajrami ka renditur një sërë shkeljesh që, sipas tij, e bëjnë këtë gjykatë të paligjshme dhe të paragjykuar: mbajtje të gjatë e të pajustificuar në paraburgim, mohimi i barazisë së palëve në proces, dëshmi të fabrikuar e të përcjella nga shërbimet sekrete serbe, si dhe

mungesë totale transparence dhe monitorimi ndërkombëtar. Në lidhje me aktakuzën për “ndërmarrje të përbashkët kriminale”, Bajrami ka thënë se ajo është juridikisht e paqëndrueshme dhe politikisht e rrezikshme. “UÇK-ja nuk ka qenë ushtri shtetërore me komandë qendrore. Ishte një lëvizje popullore, një guerile patriotike që s’kishte as strukturë shtetërore dhe as plan të përbashkët kriminal. Plan i vetëm shtetëror ishte ai i Serbisë për shfarosjen e shqiptarëve, përmes

operacionit gjenocidal ‘Patkoi’”, ka thënë akademik Bajrami, duke kritikuar institucionet e Kosovës për dështimin në mbështetjen e të akuzuarve dhe në ndërkombëtarizimin e shkeljeve që po ndodhin në këtë proces. Ndërsa profesori universitar i të Drejtës Penale, Ismet Salihu, ka thënë se akuzat ndaj katër liderëve të UÇK-së, Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqit shkaktojnë pasoja jo vetëm për luftën e drejtë të UÇK-së, por edhe për Kosovën, pavarësia e së cilës është e njohur nga më shumë se 100 shtete. “Pjesëtarë të UÇK-së gjatë luftës nuk kanë kryer krime kundër serbëve dhe pjesëtarëve të nacionaliteteve tjera. Ndërsa forcat ushtarake, policore kanë vepruar të kundërtën. Për të gjitha këto krime janë dënuar një numër i vogël, kurse krimet janë me mijëra e mijëra. Ka katër vite, që një ndër themeluesit të UÇK-së është duke u zhvilluar një proces gjyqësor”, ka thënë Salihu. Liderët e UÇK-së që nga viti 2020 janë duke u mbajtur në paraburgim në Hagë. Procesi gjyqësor ndaj tyre ka filluar në prill në vitin 2023.



APELI I SPECIALES IA UL DËNIMIN PJETËR SHALËS NË 13 VJET BURGIM

HAGË, 14 KORRIK - Paneli i Gjykatës së Apelit në Dhomat e Specializuara të Kosovës në Hagë ka vendosur t’ia ulë dënimin në 13 vjet burgim Pjetër Shalës, i gjetur fajtor për krime lufte të kryera në vitin 1999. Paneli ka rrëzuar shumicën e pikave të ankesës së Shalës, përfshirë shkeljet e pretenduara të të drejtave të tij gjatë procedimit të materialeve të dëshmitarëve dhe pretendimet se gjykimi filloi para se mbrojtja të ishte gati për këtë, por gjeti shkelje në aktgjykimin e Themelores. Anëtar i trupit gjykues, Kai Ambos, i cili e ka lexuar aktgjykimin, ka thënë se Apeli miraton pjesërisht pikat 7, 12 dhe 14 të apelit të Shalës, kurse rrëzon apelin për aspektet e tjera. Rrjedhimisht, paneli ka caktuar “dënimin unik me 13 vjet burgim që hyn në fuqi menjëherë”. Shala, ish-pjesëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), ishte dënuar me 18 vjet burgim në korrik të vitit 2024, pasi ishte gjetur fajtor për ndalim arbitrar, torturë dhe vrasje të paligjshme në Fabrikën e Metalit në Kukës - pjesa veriore e Shqipërisë. Sipas aktakuzës, ai dhe pjesëtarë të tjerë të UÇK-së morën pjesë në ndalimin dhe



keqtrajtimin e të dyshuarve për bashkëpunim me Serbinë dhe të atyre që nuk merrnin pjesë aktive në luftime. Viktimat, sipas aktakuzës, ishin subjekt i dhunës fizike dhe psikologjike, përfshirë kërcënimet me vdekje, poshtërimet dhe ngacmimet. Gjykata e ka urdhëruar Shalën të paguante edhe 208 mijë euro si kompensim për tetë viktima, ndërsa e shpalli të pafajshëm për veprën penale të trajtimit çnjerëzor. Mbrojtja e tij e kishte apeluar si aktgjykimin ashtu edhe urdhrin për zhdëmtimin e viktimave. Megjithatë, vendimi për këtë të fundit nuk është përfshirë në aktgjykimin që është shpallur të hënën. Dhomat e Specializuara të

Kosovës, të njohura ndryshe si Gjykata Speciale, punojnë me ligjet e Kosovës, por prokurorët dhe gjyqtarët e tyre janë ndërkombëtarë. Gjykata Speciale është themeluar në vitin 2015 për t’i hetuar ish-pjesëtarët e UÇK-së të cilët dyshohet se kanë kryer krime lufte dhe krime të tjera nga janari i vitit 1998 deri në dhjetor të vitit 2000. Selia e Speciales është vendosur në Hagë të Holandës për shkak të, kinse, shqetësimeve se sistemi i drejtësisë në Kosovë nuk është mjaftueshëm i pavarur për t’i hetuar krimet e luftës si dhe për shkak të dyshimeve për kërcënimin e dëshmitarëve. Deri më tani Gjykata Speciale ka shpallur dy aktgjykime për

OVLUÇK-ja: Vendimi ndaj Pjetër Shalës thellon bindjen se Specialja ka karakter politik

Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVLUÇK) ka reaguar pas vendimit të Gjykatës së Apelit të Speciales për Pjetër Shalën. Kjo organizatë është shprehur thellësisht e pakënaqur me vendimin e Apelit të Gjykatës për uljen e dënimit të ish-komandantit të UÇK-së, Pjetër Shala, nga 18 në 15 vjet burgim. OVLUÇK-ja ka theksuar se “edhe pse dënimi është ulur, ne kemi pritur me bindje të plotë një vendim lirues, sepse besojmë në pafajësinë e bashkëluftëtarëve tanë, dhe në luftën tonë të drejtë për

çlirim”. “Ky aktgjykim, në vend që të përmbyllë padrejtësinë, veçse e thellon bindjen tonë se kjo gjykatë ka karakter politik dhe nuk e trajton drejtësinë mbi baza të barabarta e të paanshme”, është thënë në reagimin e kësaj organizate. OVLUÇK-ja ka vlerësuar se “UÇK-ja nuk ka nevojë të mbrohet nga e vërteta”, se “e vërteta historike është në anën tonë” dhe se “bashkëluftëtarët tanë nuk do t’i nëpërkëmbë askush me procese të motivuara politikisht”. “Liria nuk gjykohet, ajo respektohet!”, është thënë në reagimin e OVLUÇK-së.

krime lufte ndaj Salih Mustafës dhe Pjetër Shalës dhe dy tjera për pengim të administrimit të drejtësisë ndaj Nasim Haradinajt dhe Hysni Gucatit. Aktualisht është duke vazhduar procesi gjyqësor kundër ish-presidentit të

Kosovës, Hashim Thaçi, ish-deputetit Rexhep Selimi dhe dy ish-kryetarëve të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli dhe Jakup Krasniqi, që të gjithë ish-pjesëtarë të UÇK-së, të cilët akuzohen, kinse, për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit.

DEPUTETI GJERMAN: KOSOVA DUHET TË BËHET ANËTARE E KËSHILLIT TË EVROPËS

Deputeti i SPD-së në Gjermani, Adis Ahmetoviq, ka thënë se Kosova duhet të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. Ai ka theksuar se qeveria gjermane do të duhej të kishte ushtruar më shumë presion mbi shtetet anëtare të Këshillit të Evropës që Kosova të bëhej anëtare e kësaj organizate. Ahmetoviq në këtë intervistë për “DW” ka folur edhe për të drejtat e shqiptarëve në Luginën e Preshevës. Ai ka thënë se Serbia nuk mund të kërkojë të drejta për serbët në Kosovë e t’i shkelë të shqiptarëve në Luginë

Deputeti i Partisë Socialdemokrate të Gjermanisë (SPD), Adis Ahmetoviq, në intervistë për “Deutsche Welle (DW)” ka folur për Srebrenicën, Kosovën dhe të drejtat e shqiptarëve në Serbinë e Jugut. Ai, gjithashtu, ka folur edhe për heshtjen politike për gjendjen e shqiptarëve në Serbinë e Jugut, Srebrenicën dhe vëmendjen ndaj Kosovës. Ai ka thënë se Kosova duhet të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. “Në jubileun e Këshillit të Evropës në Bundestag thashë qartë: Dëshira ime është që Kosova, kjo demokraci e re, të bëhet anëtare e plotë sa më shpejt. Nëse do të varej nga ne të SPD-së, dje e jo nesër”, ka thënë ai. Në këtë intervistë, Ahmetoviq ka folur edhe për ngërçin politik, duke thënë se Kosova ka nevojë për institucione stabile.

Z. Ahmetoviq të premten ju mbajtët në Bundestag një fjalim me rastin e ditës përkujtimore të Srebrenicës. Ju jeni i prekur personalisht nga Lufta e Bosnjës, eshtrat e gjyshit tuaj u gjetën në një varr masiv dhe u identifikuan vetëm në vitin 2016. Si e përfjetuat këtë debat?

Ahmetoviq: Jam shumë mirënjohës që në Bundestagun gjerman u zhvillua një debat i dakorduar për këtë ngjarje. Nuk përkujtuam vetëm 30-vjetorin e gjenocidit të Srebrenicës, por për herë të parë edhe Ditën Ndërkombëtare të Kujtimit për këtë krim. Vitin e kaluar, qeveria gjermane, në bashkëpunim me Ruandën, arriti të fitojë shumicën në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së për ta shpallur këtë ditë si ditë ndërkombëtare përkujtimore. Ky debat ishte i domosdoshëm. Edhe pas 30 vitesh ka ende aktorë politikë në Ballkanin Perëndimor, në Bosnjë-Hercegovinë, por edhe në Beograd që mohojnë gjenocidin, përpigjen të shtrembërojnë historinë dhe glorifikojnë kriminelë lufte si Ratko Mladiq apo Radovan Karagjiq. Kjo është e papranueshme. Kemi përgjegjësi – ndaj viktimave, familjarëve të tyre dhe gjithë rajonit.

Srebrenica ishte një gjenocid në tokën evropiane. Çfarë mësimesh mund të nxirren nga kjo për situatën aktuale në Ballkanin Perëndimor, veçanërisht në

Kosovë?

Ahmetoviq: Ne duhet ta ndjekim nga afër dhe vazhdimisht situatën në Ballkanin Perëndimor. Politika për Ballkanin nuk mund të jetë çështje konjunkturash, ajo duhet të jetë pjesë e përhershme e agjendës së politikës sonë të jashtme. Prandaj, unë ndjek rregullisht zhvillimet në rajon, në Shqipëri, Serbi dhe në Kosovë. Qëllimi ynë është stabiliteti në rajon. Për Kosovën, kjo do të thotë konkretisht: ne duam që ky vend të bëhet anëtar i Këshillit të Evropës sa më shpejt që të jetë e mundur. Nëse do të varej nga SPD-ja, më mirë dje sesa nesër. Srebrenica na kujton çdo ditë, se Ballkani Perëndimor nuk është periferi, por pjesë qendrore e Evropës. Shumë njerëz nga Ballkani jetojnë sot në Gjermani, janë të integruar shumë mirë dhe janë shtetas gjermanë. Edhe kjo na obligon. Rajoni duhet të jetë pjesë përbërëse e politikave tona të jashtme dhe të sigurisë dhe ky është realitet nën këtë qeveri, veçanërisht sa i përket Kosovës.

Sipas informacioneve tona, në Bundestag ka pasur një përpjekje për të miratuar një rezolutë për Srebrenicën. Përse dështoi kjo nismë?

Ahmetoviq: Mund të them me siguri se sot kemi arritur ta përkujtojmë Ditën Ndërkombëtare të Gjenocidit në Srebrenicë në një formë të denjë, me përmasa dhe në një kuadër që i përgjigjet seriozitetit të kësaj çështjeje. Unë mbajta një fjalim personalisht dhe vendosa lulen përkujtimore të Srebrenicës në jakën e xhaketës, si një shenjë të qartë solidariteti. Një shenjë tjetër e fortë ishte prania e dy të mbijetuarve të gjenocidit. Krahas ambasadorit të Bosnjës, ishte i pranishëm edhe ambasadori i Kosovës, partneri im politik Faruk Ajeti, një diplomat që bën një punë të shkëlqyer këtu në Gjermani. Dua të theksoj gjithashtu: Grupi parlamentar i SPD-së në Bundestag ka miratuar një qëndrim të vetin për 30-vjetorin dhe për Ditën e Parë Ndërkombëtare të Përkujtimit për Srebrenicën dhe këtë e ka bërë njëzëri. Kjo ishte vetëm pika e fillimit. Vitin tjetër vjen dita e dytë Ndërkombëtare e Përkujtimit, pastaj e treta, e katërta dhe ne do ta rrisim dhe do ta përmirësojmë angazhimin tonë.



Përmendët Këshillin e Evropës. A ka ndonjë plan konkret për ta vendosur anëtarësimin e Kosovës në agjendën e Këshillit të Ministrave?

Ahmetoviq: Nuk mund të përmend një datë konkrete, sepse kjo do të ishte e papërgjegjshme. Por si zëdhënës për politikën e jashtme të grupit parlamentar të SPD-së – bashkë me kolegun tim, Frank Schwabe do të bëjmë gjithçka për ta mbajtur kursin tonë. Ne duam që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës. U zhgënjyem që kjo nuk u arrit në legjislaturën e kaluar, ndonëse kishte një momentum strategjik. Po të ishte ushtruar më shumë presion, ndoshta do të kishte ndodhur. Megjithatë, nuk duhet të dorëzohemi. Në jubileun e Këshillit të Evropës në Bundestag thashë qartë: Dëshira ime është që Kosova, kjo demokraci e re, të bëhet anëtare e plotë sa më shpejt, nëse do të varej nga ne të SPD-së, dje e jo nesër.

Ndaj kujt duhej bërë më shumë presion vitin e kaluar?

Ahmetoviq: Qeveria gjermane do të duhej të kishte ushtruar më shumë presion mbi shtetet anëtare të Këshillit të Evropës. Disa vende ishin kundër. Por Gjermania ka tani më shumë peshë në Evropë dhe ne duhet të veprojmë me vetëbesim, por edhe me përlulsi. Si SPD do të kujdesemi që qeveria të jetë më aktive në këtë drejtim. Ministri i Jashtëm, z. Wadephul, është shprehur vetë se Kosova duhet të bëhet anëtare e përhershme e Këshillit të Evropës. Ne do t’ia kujtojmë këtë premtim dhe do ta gjykojmë në bazë të tij.

Një tjetër garanci për paqe është anëtarësimi në BE. Shqipëria dhe Mali i Zi shpresojnë të bëhen anëtare deri në vitin 2030. A është kjo realiste? Dhe dëgjojmë të flitet për anëtarësim të asociuar. Çfarë nënkuptojmë me këtë term?

Ahmetoviq: Një nga mësimet më të mëdha nga gjenocidi i Srebrenicës është: procesi i integrimit të gjashtë vendeve të Ballkanit Perëndimor që nuk janë ende anëtare të BE-së duhet të

marrë hov serioz. Nëse duam stabilitet dhe siguri të qëndrueshme në rajon, këto vende, përfshirë Kosovën, duhet të kenë një perspektivë reale, transparente dhe të sinqertë për anëtarësim. Dhe diçka tjetër: Anëtarësimi në NATO është po aq i rëndësishëm sa ai në BE. Të dyja nivelet – integrimi politik dhe siguria kolektive janë të lidhura ngushtë. Pa siguri, nuk ka asgjë. Njerëzit nuk kanë ikur nga Ballkani në vitet ’90 për të kërkuar punë më të mirë. Ata ikën për shkak të luftës, përndjekjes, dëbimit dhe krimeve. Që kjo të mos ndodhë më kurrë, nevojitet një përfshirje e qëndrueshme në BE dhe NATO. Nuk mund të them se kur do të ndodhë kjo. Por mund t’ju premtoj: si përfaqësues i SPD-së për politikën e jashtme, do të jap gjithçka që kjo perspektivë të bëhet reale. E vërteta është gjithashtu se shtetet vetë si Kosova, Bosnjë-Hercegovina, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut duhet të bëjnë detyrat e shtëpisë. Përgjegjësia është e dyanshme.

Kuvendi i Kosovës është i bllokuar aktualisht dhe nuk po arrin të fillojë punën. Sa e dëmshme është kjo për rrugën e Kosovës drejt integrimit evropian?

Ahmetoviq: Si socialdemokrat, jam në kontakt të ngushtë me qeverinë e Kosovës. Albin Kurti dhe partia e tij janë parti simotra me SPD-në. Të dyja i përkasin krahut të majtë progresist. Ne kemi një interes të madh për një qeveri stabile në Kosovë, një parlament funksional dhe punë parlamentare të rregullt. Për këtë arsye është urgjentisht e nevojshme që në Kosovë të rikthehet sa më shpejt stabiliteti politik. Nëse kjo arrihet dhe në vitet e ardhshme kemi një qeveri stabile, me një president shumë të vetëdijshme dhe përfaqësuese të shkëlqyer të kësaj demokracie të re, siç është zonja Vjosa Osamani, atëherë çështje si anëtarësimi në Këshillin e Evropës, procesi i integrimit në BE dhe një anëtarësim i mundshëm në NATO duhet të jenë sërish në krye të agjendës.

Këto çështje janë të ndërlidhura ngushtë. Dhe nëse të dyja palët, Kosova dhe BE-ja bëjnë detyrat e tyre, unë jam i bindur se do të ketë një perspektivë shumë pozitive.

Shqiptarët në Luginën e Preshevës ankohen për marginalizim dhe se janë të prekur nga pasivizimi sistematik i adresave të tyre. Këtë javë ju keni pritur në Bundestag një delegacion nga Lugina e Preshevës. Çfarë morët me vete nga ky takim?

Ahmetoviq: Do të jem shumë i sinqertë dhe unë jam një politikan që flet hapur: Situata e pakicës shqiptare në Serbi deri më sot nuk ka pasur vëmendjen e duhur, as në Gjermani e as në Bashkimin Evropian. Ne nuk e kemi parë mjaftueshëm situatën. Prandaj jam shumë mirënjohës që ky delegacion bëri një rrugë kaq të gjatë për të ardhur në Bundestag. Kur them “rrugë e gjatë”, nuk e kam fjalën për kilometrat, por për këmbënguljen. Ata kanë kërkuar takime vazhdimisht – nuk ka qenë e lehtë të gjejnë dëgjues. Ka pasur shumë organizata të ndryshme që kanë avokuar për këtë çështje, ndër të tjera edhe një shkencëtare nga Institutit Max Planck në Göttingen, e cila më konaktoi e më tha: “Z. Ahmetoviq, duhet ta shikoni këtë çështje”. Dhe jam i lumtur që e bëra. Nuk e kisha të qartë sa serioze dhe problematike është situata në terren. Çfarë mësova nga ky takim? Ne duhet të sigurohemi që të drejtat e pakicave të vlejné kudo. Sa i përket pakicës shqiptare në Serbi, ka tre marrëveshje për të cilat Serbia është zotuar. Ato përbajnë detyrime të qarta për integrimin e shqiptarëve në administratë, gjyqësor, polici dhe në përfaqësimin politik. Këto marrëveshje duhet të zbatohen, sepse janë parakusht për perspektivën e Serbisë drejt BE-së.

Qeveria e Kosovës dhe përfaqësuesit shqiptarë nga Serbia e Jugut kërkojnë që çështja e tyre të përfshihet në dialogun mes Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja. A e konsideroni këtë kërkesë legjitime?

Ahmetoviq: Pakica serbe në Kosovë ka të drejtë legjitime të kërkojë të drejtat e veta. Përse të mos vlejné standardet që kërkon qeveria serbe për serbët në Kosovë edhe për shqiptarët në Serbi? Unë mendoj se këto standarde duhet të vlejné për të gjitha pakicat për pakicat në Serbi, si edhe për pakicat në Kosovë. Prandaj unë e gjej legjitime kërkesën e pakicës shqiptare në Serbi që të futet në agjendën e dialogut midis Serbisë dhe Kosovës që modernon BE-ja. Unë e mora këtë kërkesë si detyrë për punën time dhe do ta adresoj.

GRENELLI E AKUZON OSMANIN PËR ‘MANIPULIM TË FJALËVE’ TË TRUMPIT

PRISHTINË, 14 KORRIK - Richard Grenell, i dërguari i presidentit amerikan për Misionin të Posaçme, e ka kritikuar presidentin e Kosovës, Vjosa Osmani për, siç ka thënë, “manipulimin e fjalëve” të presidentit amerikan Donald Trump. Ai i është referuar një deklaratë të Osmanit të bërë më herët gjatë javës së kaluar në Uashington, përgjatë së cilës i ka konfirmuar deklaratat e presidentit Trump se ai e ka parandaluar një përshkallëzim të mundshëm nga Serbia në Kosovë “në javët e fundit”. “Donald Trump është nominuar për Çmimin Nobel për Paqe për punën e tij për paqe dhe normalizim ekonomik mes Kosovës dhe Serbisë më 2019 dhe 2020 përmes nënshkrimit të Marrëveshjes së Uashingtonit në Zyrën Ovale. Osmani nuk ka qenë pjesë e asaj marrëveshjeje. Pretendimi që ka pasur diçka të re është absurde”, ka thënë Grenelli përmes një postimi në platformën “X”. Në nëntor të vitit 2019 Grenelli ishte emëruar nga Trumpi i dërguar i posaçëm për negociatat në mes të Kosovës

dhe Serbisë dhe ai ka qenë i përfshirë nga afër në këtë proces. Në mandatin e parë të Trumpit, më saktësisht më 2020, Kosova dhe Serbia kanë nënshkruar një marrëveshje për normalizim të marrëdhënieve ekonomike, e njohur si Marrëveshja e Uashingtonit, e cila nuk është zbatuar kurrë në tërësi. Vetë Trumpi i ka përmendur Kosovën dhe Serbinë në disa raste në javët e fundit, duke thënë se ka parandaluar një konflikt mes tyre, por pa ofruar hollësi për periudhën kohore. “Serbia, e dini, po përgatitej për luftë, me një grup që as nuk do ta përmend, sepse nuk ndodhi. Ne arritëm ta parandalonim, por kam një mik në Serbi që tha se do të shkojë përsëri në luftë. Nuk do të them se është Kosova, por është Kosova. Ata po përgatiteshin për një luftë serioze. Ne e parandaluam. E parandaluam për tregti. Ata donin të tregtonin me Shtetet e Bashkuara. Unë thashë: ne nuk tregtojmë me ata që luftojnë”, kishte deklaruar Trumpi më 29 qershor. “Radio Evropa e Lirë” e ka



kontaktuar Shtëpinë e Bardhë për sqarim lidhur me këto deklaratat, por nuk ka marrë përgjigje. Përgjigje nuk ka nisur as Qeveria në detyrë e Kosovës, kur është pyetur se për çfarë lloj përshkallëzimi të situatës bëhet fjalë. Misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, i ka thënë “Radios Evropa e Lirë” se Ballkani Perëndimor vazhdon të ketë rëndësi strategjike për aleancën dhe ajo është e përkushtuar për stabilitet rajonal. Megjithatë,

KFOR-i nuk ka dashur t'i komentojë deklaratat e fundit të Osmanit dhe Trumpit, duke thënë se për to duhet referuar tek institucionet e Kosovës dhe ato të ShBA-së. Pas deklaratave të Grenellit, Osmani ka paralajmëruar konferencë për medie menjëherë pas kthimit nga Shtetet e Bashkuara në Kosovë në ditët në vazhdim. Edhe autoritetet serbe kanë thënë se presidentja Osmani po e akuzon rrejshëm Serbinë dhe po manipulon me fjalët e

Trumpit. “Fatkeqësisht, duket se manipulimet dhe fabrikimet janë mënyra e vetme që Osmani dhe Prishtina ta marrin vëmendjen e Uashingtonit”, ka shkruar ministri i Jashtëm serb, Marko Gjuriqnë “X”. Deklaratat e Osmanit i ka hedhur poshtë edhe presidenti serb Aleksandar Vuçiq më 12 korrik. “Nuk e kemi angazhuar asnjë ushtar, nuk e kemi nisur asnjë makineri, as nuk na shkon mendja. Ne duam të punojmë, të ndërtojmë”, ka thënë ai. Këto deklaratat vijnë në një kohë kur tensionet në mes të Kosovës dhe Serbisë mbeten të larta, sidomos në veri të Kosovës, ku shumica e popullsisë është serbe. Përshkallëzimi i situatës në veri të Kosovës ka kulmuar në shtator të vitit 2023 kur një grup i armatosur serbësh, i udhëhequr nga Millan Radoiqiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, e ka sulmuar Policinë e Kosovës në fshatin Banjskë dhe ka vrarë një rreshter policie. Kosova e ka përshkruar sulmin si terrorist dhe e ka akuzuar Serbinë se qëndron pas tij, të cilën Beogradi zyrtar e ka mohuar.

KRIZA NË KUVEND DHE TË DREJTAT E SERBËVE, TEMAT E DISKUTIMIT NË MES TË HANRAHANIT DHE POLITIKANËVE

PRISHTINË, 14 KORRIK - Kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, nënkryetarja e LDK-së, Hykmete Bajrami, kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe përfaqësues të Listës Serbe janë takuar në fundjavën që shkoj me diplomatin e Zyrës së Departamentit amerikan të Shtetit për Çështje Evropiane dhe Euroaziatke, Brendan Hanrahan. Hanrahan është zyrtari më i lartë i administratës së re amerikane që viziton Kosovën. Krasniqi ka thënë se me Hanrahanin ka diskutuar për zhvillimet në Kosovë e përtej dhe ka theksuar përkushtimin e partisë së tij për bashkëpunim politik dhe zgjidhje në të mirë të qytetarëve. Ndërsa Hykmete Bajrami ka thënë se në takimin me Hanrahanin ka folur për krizën institucionale në Kosovë, referencë për moskon-



stituimin e Kuvendit të Kosovës. Bajrami ka thënë se LDK-ja qëndron në anën e zgjidhjeve që forcojnë institucionet, ruajnë demokracinë dhe mbi të gjitha i shërbejnë interesit shtetëror. Në anën tjetër, përfaqësuesit e Listës Serbe kanë thënë përmes një komunikate se në

takim kanë diskutuar me zyrtarin amerikan për ato që i kanë cilësuar “veprime të njëanshme të përditshme të institucioneve në Prishtinë, të cilat e përkeqësojnë më tej situatën e brishtë të sigurisë dhe cenojnë të drejtat themelore të popullit serb”. Diplomati amerikan është



takuar edhe me kryeministrin në detyrë të Kosovës, Albin Kurti, në rezidencën e të ngarkuarës me punë në Ambasadën Amerikane në Kosovë, Anu Prattipati. Përmes një komunikatë për medie, Zyra e Kryeministrit ka thënë se palët kanë diskutuar për marrëdhëniet biletarale në

mes të Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara dhe rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit. Deputetët janë duke u mbledhur prej 15 prillit për ta konstituuar Kuvendin pas zgjedhjeve parlamentare të 9 shkurtit, mirëpo nuk janë duke arritur të gjejnë kompromis për situatën e krijuar.

Orav në Gjakovë: BE-ja, partnere kyçe në zhvillimin komunal

GJAKOVË, 14 KORRIK - Për Zyrën e Bashkimit Evropian (BE) është shumë e rëndësishme dalja në teren, të takojmë njerëz të ndryshëm në mënyrë që t'i shohim mundësitë e një bashkëpunimi sa më të mirë dhe që procesi i integritetit të jetë sa më i kapshëm për të gjitha palët. Kështu është shprehur ambasador i BE-së në Kosovë, Aivi Orav, pas takimit me kryetarin e komunës së

Gjakovës, Ardian Gjini. “Jam shumë i lumtur që nga kryetari Gjini dëgjova për projekte shumë funksionale e BE-së në Gjakovë në theks të veçantë për ngrohtoren e qytetit si një projekt i financuar nga BE dhe që është shumë jetik për qytetarët e kësaj komune. Po ashtu, ne po bashkëpunojmë ngushtë me të gjitha komunat dhe popullin e Kosovës në mënyrë që procesi i integritetit të jetë sa më i shpejtë”,

ka thënë ambasadori Orav. Ndërsa kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, ka thënë se Bashkimi evropian është bindshëm kontribuuesi më i madh jo vetëm në Gjakovë, por në gjithë Kosovën përmes projekteve shumë të rëndësishme, disa prej të cilave kanë përfunduar, ndërsa pjesa tjetër janë duke u kryer. “Në të njëjtën kohë nuk është kurrë e tepërt të themi se drejtimi i

Kosovës është unioni evropian dhe ne duhet ta bëjmë maksimumin tonë si komunë, por edhe si shtet, si vend që t'i krijojmë rrethanat tona me qenë sa më afër anëtarësimit në të ardhmen në Bashkimin Evropian. Unë e falënderova ambasadorin për punën dhe zyrën e tij për gjithë kontributin që e kanë dhënë për Gjakovën”, ka thënë Gjini. I shoqëruar nga kryetari Gjini,



ambasador i BE-së në Kosovë, Aivi Orav, gjatë vizitës në Gjakovë ka zhvilluar një takim me afaristët e kësaj komune, po ashtu ka vizituar qendrën inovative dhe Muzeun e këtij qyteti.

VËLLAI I LIRIDONA ADEMAJT DËSHMON NË GJYKATË

PRISHTINË, 14 KORRIK - Në Gjykatën Themelore në Prishtinë, gjatë gjykimit ndaj Naim Murselit, i akuzuar për vrasjen e bashkëshortes së tij, Liridona Ademaj, të hënën ka dëshmuar vëllai i së ndjerës, Leonard Ademaj. Duke folur para trupit gjykues, Ademaj e ka përshkruar momentin kur e kishte kuptuar vrasjen e motrës. Ai ka thënë se ishte në punë kur bashkëshortja e kishte telefonuar, duke i thënë që të shkonte në shtëpi, sepse Liridona ishte vrarë. Fillimisht ai ka thënë se i kishte marrë prindërit dhe kishin shkuar në spitalin “Isa Grezda” në Gjakovë, ku ka kërkuar qetësues për ta. Më pas janë nisur për në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës në Prishtinë, ku ka thënë se kishin parë shumë policë, të cilëve u është drejtuar për informacione. Ata e kishin udhëzuar të shkonte në stacionin policor në

Dragodan, ku një police ua kishte kumtuar lajmin për vdekjen e Liridonës. Ademaj ka thënë se, kur kishte pyetur për Naimin, i ishte thënë se ai po jepte deklaratë në polici. Rreth një orë e gjysmë më vonë, Naimi kishte dalë nga stacioni. “Për ne ajo natë nuk ishte e lehtë, se i kishim edhe fëmijët (e Liridonës). Kemi qëndruar zgjuar deri në mëngjes”, ka thënë Ademaj. Ai ka treguar se, pasi kishte kontaktuar shoferin me të cilin ishte Naimi, kishte mësuar se ai ndodhej në hotelin “Swiss” në Prishtinë. Aty kishte shkuar bashkë me disa të afërm dhe e kishin gjetur Naimin të shtrirë në krevat, me ushqime në tavolinë dhe me drekë të porositur. Ata menduan se sjellja e tij pasqyronte tronditjen, ka thënë Ademaj, raporton “Betimi për Drejtësi”. Liridona Ademaj është vrarë më 29 nëntor të vitit 2023 në



Prishtinë. Aktakuza e ngarkon Murselin se ka planifikuar vrasjen e bashkëshortes me qëllim hakmarrjeje dhe përfitimi financiar nga një sigurim jetësor në Suedi, në shumë prej rreth 260 mijë eurosh. Sipas

Prokurorisë, Murseli e ka planifikuar vrasjen në bashkëpunim me Kushtrim Kokallën dhe Granit Plavën, duke u premtuar atyre një shpërblim prej 30 mijë eurosh për ta kryer krimin. Kokalla

akuzohet se e kishte njoftuar Murselin me dorasin Plava. Plava akuzohet se ka kryer vrasjen. Murseli dhe Kokalla u deklaruan të pafajshëm, ndërsa Plava nuk pranoi të deklarohej për fajësinë.

RASTI ‘VETERANËT’, DHJETË TË AKUZUAR DËNOHEN ME NGA NJË VIT BURGIM, DY TË TJERË LIROHEN

PRISHTINË, 14 KORRIK - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur vendimin për rastin e njohur si “Veteranët”. Në këtë rast, për keqpërdorim të detyrës zyrtare, akuzohen ish-kryeministri Agim Çeku, ish-ministri i Mbrojtjes, Rustem Berisha, ish-deputeti Shkumbin Demalijaj, Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Faik Fazliu, Smajl Elezaj, Fadil Shurdhaj dhe Xhavit Jashari. Gjykata ka vendosur që të gjithë të dënohen me nga 1 vit burgim, përveç Nuredin Lushtakut dhe Smajl Elezajt që janë liruar nga akuzat.

Gjykata Themelore në Prishtinë më 16 prill 2021 të akuzuarit i kishte liruar nga akuzat, por Gjykata e Apelit më 26 prill 2022 e ka kthyer në rigjykim këtë rast. “Departamenti Special i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, ka vendosur që ta aprovoj ankesën e Prokurorisë Speciale të



Kosovës, ndërsa ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, PKR nr. 230/2018, i datës 16 prill 2021 dhe kjo çështje penale do t'i kthehet në rigjykim dhe rivendosje të njëjtës gjykatë”, ishte thënë në njoftim. Të dyshuarit edhe herën e parë ishin liruar nga akuzat. “Me aktgjykimin e lartcekur të Gjykatës Themelore në Prishtinë, të akuzuarit A.Ç., N.L., S.H.,

Sh.D., Q.G., Sh.B., A.D., Rr.B., F.F., S.E., F.Sh. dhe Xh.J., janë liruar nga akuzat për shkak të veprës penale në bashkëkryerje keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar, nga neni 422, paragrafi 1. lidhur me nenin 31 të KPRK”, ishte thënë në njoftimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë. Me aktakuzën e PSRK-së, po ashtu, ishte kërkuar që Gjykata Themelore në Prishtinë ta urdhërojë Ministrinë e Punës dhe

Mirëqenies Sociale (MPMS) që ta pezullonte pagesën e pensioneve për 19 mijë e 500 veteranë deri në përfundimin e procesit gjyqësor, raporton “Betimi për Drejtësi”. Por, më 1 prill 2019, gjykata e kishte refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se propozimi për masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së si palë e tretë. Sipas aktakuzës së përgatitur nga ish-prokurori special, Elez Blakaj,

personat e përfshirë ishte thënë se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtarë të Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kanë shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Sipas Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), të akuzuarit duke keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, për kohën sa ishin pjesë e Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së UÇK-së, i kanë shkaktuar dëm buxhetit të Kosovës në vlerë prej 88.769.217.04 eurosh.

Suspendohen katër policë në dy raste të ndara

PRISHTINË, 14 KORRIK - Inspektorati Policor i Kosovës i ka rekomanduar policisë që t'i suspendojë katër zyrtarë të saj për dy raste të ndara, në Ferizaj dhe Prishtinë. IPK-ja ka njoftuar se në rastin e parë fillimisht Policia e Kosovës kishte pranuar informacion të dielën mbrëma për një incident në një fshat të Ferizajt ku dyshohej se një i mitur ishte sulmuar dhe kanosur me armë nga një person me rroba civile e që është paraqitur si zyrtar policor. “Njësitët policore kanë dalë në vendin e

ngjarjes, kurse më vonë personi i dyshuar është identifikuar si zyrtar policor (jashtë detyrës zyrtare) dhe i njëjti është vetëparaqitur në stacion policor pas incidentit. Në interes të hetimit IPK i ka rekomanduar policisë suspendimin për zyrtarin në fjalë kurse rasti do të trajtohet në procedurë të rregullt në koordinim me Prokurorinë Themelore në Ferizaj me dyshimin për veprën penale ‘Lëndim i lehtë trupor’, ka njoftuar IPK-ja. Në rastin tjetër, IPK-ja, në

interes të hetimit, ka rekomanduar suspendimin për tre zyrtarë policorë, ndërsa incidenti ku dyshohet se janë të përfshirë si të dyshuar zyrtarët raportohet të ketë ndodhur para mesnatës së 30 qershorit në rrugën “Muharrem Fejza” në Prishtinë. Hetimet lidhur me këtë rast ndaj tre zyrtarëve policorë janë duke u zhvilluar në koordinim me Prokurorinë Themelore në Prishtinë në procedurë të rregullt me dyshimin për veprën penale



“Keqtrajtim gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ose autorizimeve publike”. Hetuesit e IPK-së në konsultim të vazhdueshëm

me prokurorinë pritet të ndërmarin edhe veprime të tjera hetimore lidhur me këtë rast për t'i sqaruar rrethanat e dy rasteve.

TRIDHJETË SHKELJET E GJYKATËS SPECIALE



Shkruan: Akademik
Arsim BAJRAMI

Gjykata Speciale ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, duke cënuar proceset e drejtësisë dhe duke injoruar të drejtat themelore të individëve. Më poshtë janë disa nga shkeljet përkatëse:

I

1. Gjykata Speciale: Është një tendencë e hapur, që përmes këtij procesi, krejtësisht të montuar, ta shtrembërojë të vërtetën për historinë moderne të Kosovës, në radhë të parë dhe ekskluzivisht për ta keqinterpretuar luftën e drejtë çlirimtare, të popullit të Kosovës, luftën për vetëmbrojtje, çlirimin nga sundimi serb, nga gjenocidi shtetëror serb.

2. Për më tepër, Gjykata Speciale, përmes Serbisë, është derivat i Raportit të rremë dhe të falsifikuar të Dick Martyt, dhe kjo, tanimë, dihet botërisht, pra edhe nga drejtësia ndërkombëtare.

3. Pas dekonspirimit të Raportit falsifikues, të Dick Martyt, i sponsorizuar nga Rusia dhe nga Serbia, Këshilli i Evropës dështoi ta thoshte të vërtetën jo vetëm para popullit të Kosovës, por edhe para drejtësisë dhe opinionit ndërkombëtar, për atë mashtrim ordiner. Duke heshtur, qëllimisht, dhe duke e fshehur të vërtetën për inskenimet, mashtrimet e Raportit të Martyt, Këshilli i Evropës krijoi huti në opinionin ndërkombëtar, ndaj e vërteta për Raportin trillues të Dick Martyt u mjegullua, u fsheh. Në këtë mënyrë, me politikat obstruktive edhe të Këshillit të Evropës, tek opinionin botëror u krijuan paragjykiye të tmerrshme për luftën tonë çlirimtare. Këshilli i Evropës, edhe sot, vazhdon të heshtë për të vërtetën se lufta e popullit të Kosovës, nën drejtimin e UÇK-së, me veprimet e saj guerile, ishte luftë e drejtë, çlirimtare. Pikërisht UÇK-ja, e cila lindi nga populli, krijoi aleancën diplomatike dhe ushtarake me NATO-n, me ShBA-në. Prandaj, Këshilli i Evropës mban përgjegjësi jo vetëm juridiko-penale, përse lejoi që mbi një Raport të falsifikuar, me ndihmën e drejtpërdrejtë të shtetit serb dhe të aleatëve të saj, të ngrejë aktakuzë ndaj personaliteteve, të cilat, gjatë luftës së Kosovës dhe pas Çlirimit, ishin aleatë diplomatikë dhe ushtarakë të NATO-s, të ShBA-së dhe të shteteve të tjera të Bashkimit Evropian.

4. E formuar me mirëbesim nga Kuvendi i Kosovës, përmes Amendamentit 24 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Gjykata

Speciale duhej të zhvillonte një proces gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm, e jo të binte pre e komplotit të shtetit serb në bashkëpunim me Dick Martyn dhe me shërbimet sekrete të Rusisë. Tanimë, procesi gjyqësor, krejt i padrejtë, tendencioz, që po zhvillohet në Gjykatën Speciale në Hagë, kundër çlirimtarëve dhe personaliteteve politike të Kosovës, po dëshmohej se po mbështetet në aktakuzën e rreme, mashtruese, përplot falsifikime, me dëshmitarë të përpunuar, të shantazhuar nga Serbia.

5. Në vend të kësaj, ajo u shndërrua në një Gjykatë diskriminuese dhe monoetnike, e cila pretendon të inkriminojë luftën çlirimtare dhe të drejtë të UÇK-së, duke mos u marrë fare me krimet serbe dhe me gjenocidin shtetëror të Serbisë ndaj popullatës duarthatë të Kosovës. Ushtria serbe, formacionet paraushtarake serbe, gupet kriminale, nën udhëheqjen e Arkanit, vranë mbi 14.000 civilë shqiptarë, në mesin e të cilëve edhe 1.550 fëmijë, ndër ta, më i vogli, gjashtë muajsh nga Komuna e Drenasit.

6. Pavarësisht se kjo Gjykatë pretendon se nuk po gjykohej UÇK-ja, por gjoja “ krimet” individuale të pjesëtarëve të saj, ky është një mashtrim, sepse katër udhëheqësit e saj, të cilët vazhdojnë të jenë në paraburgim, ishin protagonistët eminentë, të procesit të çlirimit, të shtetndërtimit dhe të Pavarësisë së Kosovës.

7. Ne vlerësojmë se qëllimi i këtij gjykimi po merr karakter të hapur dhe shumë të rrezikshëm politik, me synimin e balancimit të krimeve e gjenocidit të Serbisë në Kosovë me ndonjë akt të rastësishëm vandal, të izoluar që mund ta ketë kryer ndonjë individ në kohë lufte, madje duke mos qenë fare pjesëtar i UÇK-së.

8. Edhe pse formalisht është pjesë e sistemit gjyqësor të Kosovës, deri më tani Gjykata Speciale ka bërë shkelje kushtetuese, ligjore dhe ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sidomos në lidhje me të drejtat e njeriut, prezumicioni i pafajësisë dhe parimet e tjera ndërkombëtare, për një gjykim të drejtë, të paanshëm dhe vetëm mbi bazën e fakteve, dëshmive. Por, jo të inskenojë, të trillojë situata të sajura në bazë të dëshmive të fabrikuara të shtetit, të prokurorisë serbe dhe të dëshmitarëve të përpunuar të mbrojtur! Këtyre ditëve u bënë publike transkriptimet e bisedave të një dëshmitari shqiptar, tanimë të mbrojtur, me krerët e Shërbimit Sekret të Serbisë, menjëherë në vitet e para të Çlirimit të Kosovës, me ç'rast dëshmitari i Serbisë flet për dëmshpërblimin financiar, me këste mujore, që, për shërbimet e tij, duhej t'ia paguante shteti serb!

9. Për më tepër, Gjykata Speciale ka mohuar çdo bashkëpunim me autoritetet e Kosovës, duke mos e njohur Kushtetutën, simbolet

shtetërore dhe legjislationin e saj. Kjo është një shkelje brutale e Gjykatës Speciale ndaj sovranitetit juridiko-kushtetues të Republikës së Kosovës, Kuvendi i së cilës i miratoi të gjitha aktet nënligjore për themelimin e Gjykatës Speciale.

10. Ne kemi dëshmi se Gjykata Speciale ka vazhduar të zhvillojë bashkëpunim me autoritetet e Serbisë, duke përfshirë Prokurorinë e saj Speciale, BIA-n serbe, qoftë në marrjen e materialeve, apo në trajnimet e dëshmitarëve për të inkriminuar pjesëtarët e UÇK-së. Ky veprim i Gjykatës Speciale është jodemokratik dhe paraqet shkelje të hapur të së drejtës ndërkombëtare.

II

Cilat janë shkeljet kushtetuese dhe ligjore të Gjykatës Speciale?

1. Gjykata Speciale ka shkelur Kushtetutën e Republikës së Kosovës, veçanërisht Kapitullin II për Liritë dhe të Drejtat e Njeriut, duke cenuar prezumicionin e pafajësisë, një nga parimet bazë të së Drejtës Penale Ndërkombëtare.

2. Gjykata Speciale ka shkelur Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e saj, të cilat u referohen të drejtave të njeriut dhe procedurës së drejtë dhe të pavarur gjyqësore.

3. Gjykata Speciale ka shkelur të gjitha parimet kushtetuese dhe ligjore, duke mbajtur në paraburgim arbitrar dhe të paligjshëm katër pjesëtarët e UÇK-së për më shumë se katër vjet. Arsyetimi i kësaj gjykate, për vazhdimin arbitrar të paraburgimit, “ për gjoja rrezikun e ikjes së të akuzuarve”, është “arsyetim”, është shpjegim qesharak dhe i paqëndrueshëm, sepse katër pjesëtarët që po gjykohen janë vetëdorëzuar dhe Kosova, edhe në rastin përkatës, është shembulli më i mirë i bashkëpunimit me drejtësinë ndërkombëtare.

4. Gjykata Speciale ka shkelur parimin e “barazisë së palëve” në procedurën penale. Në vend të paanshmërisë në raportet mes Prokurorisë dhe të akuzuarve, ajo haptazi ka anuar në favor të Prokurorisë, duke mbështetur çdo tendencë, çdo veprim të saj për të inkriminuar të akuzuarit dhe duke mohuar e minimizuar provat mbrojtëse dhe shfaqëse të avokatëve të të akuzuarve.

5. Gjykata Speciale ka ndërtuar një sistem piramidal dhe të mbyllur në një ndërtesë të të gjitha institucioneve gjyqësore dhe prokuroriale, duke përfshirë Gjykatën Kushtetuese, Avokatin e Popullit etj. Ky organizim në formë çarku të mbyllur, paraqet “konflikt interesi”, sepse rritë mundësitë e ndikimit në vendimmarrje dhe në pavarësinë e institucioneve brenda kësaj Gjykate.

6. Gjykata Speciale, në vend të parimit të ekonomizimit të procesit gjyqësor, po zhvillon një gjykim maratonik, të panjohur deri më tani në analet e drejtësisë

ndërkombëtare. Kjo zgjatje e gjykimit mund të ketë përfitime të larta financiare për gjyqtarët, për prokurorët dhe punonjësit administrativë në Gjykatën Speciale, që tejkalojnë pagat e kolegëve të tjerë në shtetet e tyre.

7. Gjykata Speciale vazhdon të ndërmarrë masa diskriminuese ndaj të akuzuarve, duke mos iu siguruar kushte të përshtatshme për mbrojtjen e tyre, duke ua vonuar dorëzimin e materialeve dëshmitarëve të mbrojtur, si edhe duke vendosur restriksione të vizitave dhe masa të tjera diskriminuese. Ishte përvojë jashtëzakonisht kundër të drejtave dhe lirive të njeriut, pra edhe të paraburgosurve, akti i përgjimeve, të cilat i janë bërë Hashim Thaçit nga bashkëbisedimet me vizitorët.

8. Gjykata Speciale ka dështuar të jetë transparente në punën e saj. Shumica e seancave gjyqësore dhe e materialeve janë redaktuar, ka munguar informimi i opinionit të Kosovës dhe përgjithësisht atij shqiptar për ecurinë e procesit gjyqësor, ndërkohë që konferencat e kohëpaskohshme të kryetares Trandafilova kanë qenë të censuruara.

9. Gjykata Speciale nuk ka asnjë monitorim ndërkombëtar të organizatave ndërkombëtare, të cilat monitorojnë respektimin e të drejtave të njeriut në këtë proces gjyqësor.

10. Gjykata Speciale në aspektin profesional nuk përbëhet nga gjyqtarët dhe prokurorët e nivelit të ulët apo të mesëm profesional dhe një pjesë e tyre ka shërbyer në UNMIK dhe në EULEX, me ç'rast, kanë dështuar në proceset e drejtësisë transicionale në Kosovë për çka janë paguar. Ata tani po paguhen për së dyti për të njëjtat çështje për të cilat, më parë, kanë dështuar.

III

Pse aktakuza për të ashtuquajturën “Ndërmarrje të përbashkët kriminale” (NPK) është e pabazë.

Kjo aktakuzë paraqet një konstruksion juridiko-politik, i cili është i paqëndrueshëm në aspektin penalo-juridik për arsyet sa vijon:

1. UÇK-ja nuk ka qenë ushtri e rregullt, por një guerile patriotike e formuar dhe e udhëhequr nga idealistë dhe patriotë të rinj të Kosovës, shumica prej tyre studentë, që nuk janë pajtuar me okupimin dhe me dhunën barbare serbe ndaj popullit paqedashës shqiptar. Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pasur një strukturë komanduese unike dhe të centralizuar, por luftëtarët vullnetarë kanë vepruar në disa zona ushtarake, të cilat kanë vepruar në mënyrë vetjake, pa një sistem të hierarkisë së komandimit.

2. NPK nënkupton ekzistencën e një plani shtetëror të përcaktuar, të dizajnuar, të udhëhequr dhe të financuar nga shteti. Pas UÇK-së nuk ka qëndruar shteti, sepse Kosova ka qenë e okupuar nga

Serbia, e cila dhunshëm administronte Kosovën me aparatën e saj represiv të instaluar në Kosovë.

3. Ndërmarrje e përbashkët kriminale ishin ushtria, policia serbe, njësitet paraushtarake, të cilat bënë gjenocid shtetëror në Kosovë gjatë viteve 1998-1999, i zbatuar me planin gjenocidal “Patkoi” dhe planet e tjera shfarosëse të Serbisë. Udhëheqës dhe zbatues të këtij plani gjenocidal kanë qenë kreu shtetëror dhe ai ushtarak i Serbisë, që janë dënuar nga TPNJ.

4. Lufta e UÇK-së, së bashku me popullin e Kosovës, sipas të gjitha konventave dhe ligjeve ndërkombëtare të luftës, ka qenë luftë e drejtë, mbrojtëse, çlirimtare dhe ka pasur për qëllim largimin e forcave ushtarake dhe policore serbe nga Kosova, mbrojtjen e popullsisë civile, të të gjitha etniteteve dhe pavarësimin e Kosovës, pra themelimin e shtetit të Kosovës. Akti, vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, sipas të cilit Kosova u shpall shtet i pavarur, në frymën e ligjeve ndërkombëtare dhe të së drejtës së popullit të saj, që në territorin e vet ta shpallë pavarësinë e Kosovës, është dëshmia më e fuqishme se UÇK-ja dhe mbarë populli i Kosovës zhvilluan luftë të drejtë, çlirimtare, vetëmbrojtëse.

5. Aktakuza e Gjykatës Speciale në aspektin politik ka për qëllim dhe tendencë të hapur rishikimin e historisë së lirisë së Kosovës, komprometimin e luftës sonë çlirimtare dhe të shtetndërtimit të Kosovës. Kjo tendencë mund të ketë pasoja të rënda politike në arenën ndërkombëtare, për shtetin e Kosovës, dhe është një presion për kompromise të reja politike në emër të “pajtitimit” ndëretnik, të cilin po e imponon Serbia.

IV

Cilat janë dështimet e Kosovës në procesin e Gjykatës Speciale Republika e Kosovës si themeluese e Gjykatës Speciale ka dështuar me sa vijon:

1. Të ofrojë ndihmën e nevojshme financiare dhe juridike për shtetasit e Kosovës, të cilët po gjykohen në Hagë.

2. Të ofrojë prova, dokumente dhe materiale të tjera me qëllim të mbrojtjes së luftës së drejtë, çlirimtare, vetëmbrojtëse të UÇK-së.

3. Të ofrojë garanci shtetërore dhe juridike për lirinë e të akuzuarve nga paraburgimi.

4. Të sensibilizojë komunitetin ndërkombëtar për shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut të përcaktuara me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në rastin konkret të akuzuarve në këtë proces gjyqësor.

5. Të organizojë dhe të financojë shoqërinë civile, mediet, shoqatat profesionale, komunitetin akademik në argumentimin profesional, juridik, politik dhe shkencor të Luftës së drejtë Çlirimtare të UÇK-së.

882 milionë euro të bllokuara për shkak të moskonstituimit të Kuvendit

PRISHTINË, 14 KORRIK - Drejtori ekzekutiv i Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) ka ngritur shqetësimin se vendi tash e tre muaj ndodhet pa Kuvend funksional dhe, sipas tij, për shkak të kësaj

bllokade institucionale, Kosova nuk po arrin të përfitojë nga fondet e Planit të Rritjes së Bashkimit Evropian (BE). Ai ka thënë se janë bllokuar 882 milionë euro për shkak të moskonstituimit të

Kuvendit. “882 milionë euro të bllokuara për shkak të një Kuvendi që nuk po bëhet. Dëm i interesave të ngushta partiake”, ka shkruar Kryeziu në “Facebook”. Plani i Rritjes së BE-së për Ballkanin Perëndimor

parasheh disbursimin e këtyre fondeve, por ato mund të kalojnë vetëm pasi të ratifikohen marrëveshjet përkatëse në Kuvendin e Kosovës. Pa funksionalizimin e tij, procesi mbetet i bllokuar.



OEK-U: KOMERCIALJA PEZULLON VENDIMIN E ZRRE-SË PËR DALJEN NË TREGUN E LIRË TË ENERGJISË PËR PESË KOMPANI

PRISHTINË, 14 KORRIK - Oda Ekonomike e Kosovës (OEK) përmes një njoftimi ka bërë me dije se Gjykata Komeriale e Kosovës ka pezulluar vendimin e Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRrE) për daljen në tregun e lirë të energjisë për pesë kompani të tjera të cilat kishin ushtruar padi individuale ndaj këtij vendimi. Sipas OEK-ut, këto pesë kompani kanë fituar të drejtën e tyre ligjore përmes këtij mekanizmi.

Më tutje, OEK-u i ka bërë thirrje ZRrE-së ta anulojë vendimin për daljen e detyrueshme në tregun e lirë të energjisë për ta shmangur dëmtimin e konkurrencës, bizneseve, qytetarëve dhe ekonomisë së vendit. “Gjykata Komeriale pezullon vendimin e ZRrE-së për pesë kompani të tjera. Oda

Ekonomike e Kosovës njofton për aktvendimin e radhës të Gjykatës Komeriale, e cila ka pezulluar vendimin e ZRrE-së për daljen në tregun e lirë të energjisë për pesë kompani të tjera që kanë ushtruar padi individuale ndaj këtij vendimi të ZRrE-së. Siç kemi theksuar edhe më herët, legjislacioni aktual nuk parasheh padi në formë grupore ose kolektive, prandaj vetëm paditë individuale po trajtohen dhe po pranohen nga gjykata. Këto pesë kompani kanë fituar të drejtën e tyre ligjore përmes këtij mekanizmi. Oda Ekonomike e Kosovës i bën thirrje ZRrE-së që të anulojë vendimin për daljen e dhunshme në tregun e lirë të energjisë, në mënyrë që të mos dëmtohet konkurrenca, bizneset, qytetarët dhe ekonomia e vendit”, ka njoftuar OEK-u.



KEK-u MERR DRITËN E GJELBËR NGA OShP-ja, VAZHDON PROJEKTI PËR REHABILITIMIN E NJËSISË A3 NË TERMOCENTRALIN KOSOVA A



PRISHTINË, 14 KORRIK - Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) ka njoftuar se projekti kapital për “Rehabilitimin dhe modernizimin e Njesisë A3” në Termocentralin Kosova A do të vazhdojë, pasi Organi Shqyrtues i Prokurimit (OShP) ka hedhur poshtë ankesën e një operatori ekonomik. “Projekti, i cili ishte pezulluar përkohësisht për shkak të një ankese të paraqitur nga një operator ekonomik në OShP, ka marrë tashmë dritën e gjelbër për të vijuar”, është thënë në njoftimin e KEK-ut. OShP-ja ka vendosur më 10

korrik që ankesa ishte “e palejuar” dhe ka ripohuar ligjshmërinë dhe korrektësinë e plotë të veprimeve të ndërmarra nga KEK-u. KEK-u ka ritheksuar se është i përkushtuar që ky projekt strategjik për sektorin energjetik të realizohet me “transparencë të plotë, integritet dhe profesionalizëm”, duke u bazuar në standardet më të larta të prokurimit publik dhe me dokumentacion të përgatitur në bashkëpunim me ekspertët vendorë dhe konsulencën e USAID-it.

Rritet numri i fluturimeve dhe udhëtarëve me aeroplan

PRISHTINË, 14 KORRIK - Në muajin maj të këtij viti numri i fluturimeve të realizuara ishte 1 169, ose 16.7 për qind më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas një njoftimi për medie të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), numri i udhëtarëve në

total ishte 381 458 ose 13.3 për qind më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Më tutje, në njoftim është thënë se në muajin maj 2025 numri i udhëtarëve me tren ishte 8 491 ose 22,5 për qind më shumë sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.

Ndërsa sasia e mallrave të transportuara me tren në neto ton ishte zero.

Po sipas ASK-së, në muajin maj 2025 numri i përdoruesve të rrjetit telefonik fiks ishte 68 478 me një rënie prej 1-përqindësh më pak sesa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.



SOKRATI, MËSUESI I KEQ



“Meleti, biri i Meletit, nga demo i Pitto-s, kundër Sokratit, biri i Sofroniskut, nga demo i Alopeskes, paraqiti këtë akuzë dhe u betua: Sokrati është fajtor që nuk njuh perënditë që qyteti i pranon dhe që fut hyjni të reja. Për më tepër, është fajtor për korruptimin e të rinjve. Për këtë kërkohet dënimi me vdekje.”

Kështu fillon, me këtë denoncim të depozituar në vitin 399 p.e.s. pranë arkonit të Athinës, procesi ndaj Sokratit, filozof i madh që u lartësua nga brezat pasardhës, por u akuzua nga bashkëqytetarët e tij, mbi të gjitha në një regjim demokratik si ai i Athinës. Aktorët e asaj ngjarjeje ndoshta nuk e dinin, por procedimi në të cilin ishin protagonistë do të bëhej ndër më të diskutuarit në shekuj.

I DASHUR DHE I KRITIKUAR

Kur u njoh me denoncimin ndaj tij, Sokrati ishte tashmë shtatëdhjetë vjeç. Biri i skulptorit Sofronisk, ai ishte afuar që në rini me filozofinë duke frekuentuar sofistët dhe retorët më të mëdhenj të kohës së tij, ndër ta Protagora nga Abdera dhe Gorgia nga Lentini. Po të kishim ecur në rrugët e mbushura të Agorasë, pa dyshim do ta kishim vënë re, me trupin e tij të shkurtër dhe të trashë, teksa i pyeste pa pushim bashkëqytetarët e tij për temat më të ndryshme, nga natyra e njeriut te idealet e drejtësisë dhe moralit, pa kursyer kritika për politikanët dhe demagogët. Duke ftuar në refleksim përmes një dialogu të vazhdueshëm me bashkëbiseduesit e vet, Sokrati futi në historinë e filozofisë

perëndimore maieutikën, një metodë e re për të menduar – më pas e quajtur “metoda sokratike” – dhe ishte gjithashtu i pari që i dha rëndësi të ashtuquajturit daimonion (“demon”), një lloj “zëri” të brendshëm që ishte në gjendje të udhëhiqte vendimet morale të individëve.

Falë personalitetit të tij të ndritur dhe pa komplekse, me kalimin e viteve filozofi mbledhi rreth vetes një grup ndjekësish të rinj. Pranë tyre nuk mungonin as kundërshtarët dhe tallësit, gjithmonë gati për të qeshur me çuditë e tij, si për shembull komediani i famshëm Aristofani, i cili në një nga komeditë më zbavitëse (Retë, e shfaqur në vitin 423 p.e.s.) e përshkroi si një dembel ekscentrik dhe pa sens praktik. Më shumë se një farsë, megjithatë, ngjarjet e Athinës në kohën e Sokratit i ngjanin një tragjedie.

KLIMË E NXEHTË

Pas humbjes në Luftën e përgjakshme të Peloponezit kundër Spartës, në vitin 404 p.e.s. athinasit u detyruan të duronin shembjen e demokracisë, realizuar nga partia oligarkike, e cila vendosi regjimin filo-spartan të “tridhjetë tiranëve”, përgjegjës për vrasje, konfiskime dhe përndjekje politike. E urryer nga populli, Tridhjetëshja pati jetë të shkurtër dhe vitin pasardhës u dëbuan nga qyteti, që u rikthye të qeverisej nga demokratët. Por pavarësisht përpjekjeve për të rikthyer paqen shoqërore, plagët e shkaktuara nga ato ngjarje të

dhimbshme vazhduan për një kohë të gjatë të mbillnin urrejtje dhe përçarje. Në atë klimë të ndezur politike, Sokrati u soll gjithmonë si qytetar shembullor.

Gjatë konfliktit tridhjetëvjeçar kundër Spartanëve, ai veshi armaturën e hoplitit duke luftuar në betejat e Potideas (432 p.e.s.), Deliosit (424 p.e.s.) dhe Amfipolit (422 p.e.s.); dhe në rastet e rralla kur merrej me politikë, u dallua për ndershmëri. Si anëtar i këshillit të qytetit (boulé), për shembull, në vitin 406 p.e.s. ishte i vetmi që kundërshtoi dënimin me vdekje, të konsideruar të padrejtë, të admiralëve athinas që kishin marrë pjesë në betejën e Arginusëve, të akuzuar për mos-shpëtimin e të mbyturve. Dhe nuk mjaftonte kjo: në kulmin e represioneve të regjimit të Tridhjetëshes, ai refuzoi të merrte pjesë në një grup të ngarkuar me arrestimin e një të pafajshmi.

NJOHURI TË RREZIKSHME

Por nëse Sokrati ishte treguar i moderuar, pse ndaj tij u ngritën akuza kaq të rënda? Një rol vendimtar luajti fakti që disa nga personazhet më të diskutueshëm të qytetit, të lidhur ngushtë me partinë oligarkike dhe simpatizues të Spartës, kishin qenë nxënës të tij. Ndër ta, spikatnin i riu aristokrat Alqibiadhi dhe sidomos Krizia, më i zjarri i Tridhjetë Tiranëve. Njohje të rrezikshme, të cilat u konsideruan si prova se ai ishte një “mësues i keq”, armik i

demokracisë, gjë që sipas disave, do të justifikonte një proces politik kundër tij. Përveç Meletit, biri i një poeti, për të cilin dimë pak, ata që e paditën Sokratin ishin edhe dy figura të njohura, Likoni dhe Anito, të dy politikanë të fraksionit demokratik. I pari ishte orator, i dyti, i konsideruar nga të gjithë si promovuesi i vërtetë i padisë, vinte nga një familje e pasur zejtarësh.

Sipas asaj që shkruan Platoni (nxënës i Sokratit dhe jo tamam i paanshëm), Aniti madje e kishte kërcënuar në mënyrë të fshehtë filozofin: “Do të thosha se e ke kollaj të flasësh keq për të tjerët. Nga ana ime, po të më dëgjoje, do të të këshilloja të bëje kujdes.”

Historiani Ksenofonti, gjithashtu ndjekës i Sokratit, shkon më tej, duke thënë se filozofi e kishte përçmuar Anitin për zanatin e tij si lëkurpunues, dhe e kishte këshilluar të birin që të mos ndiqte rrugën e të atit. Një arsye tjetër për t’u urryer.

AKUZAT E RRËZUARA

Por të kalojmë te procesi famëkeq. Procedura e përcaktuar nga ligjet e Athinës parashikonte dëgjimin e fjalimeve të gjata të akuzës dhe të mbrojtjes, pas të cilave një juri prej 500 qytetarësh thirrej të votonte për fajësinë ose pafajësinë e të akuzuarit. Në rastin kur të pandehurit i ngarkohej faji, ai kishte të drejtë të propozonte një dënim alternativ, për të cilin juria votonte sërish dhe në mënyrë përfundimtare. E gjitha kjo, në vetëm një ditë.

Në praninë e një publiku të madh dhe të zhurmshëm, Meleti, Aniti dhe Likoni, nga fjalimet e të cilëve nuk ka mbetur gjurmë, përsëritën pikat kryesore të akuzës: korruptimi i të rinjve dhe futja e hyjnive të reja “demonike” në vend të perëndive tradicionale të qytetarëve. Sipas fjalimit me të cilin Sokrati u mbrojt, i raportuar nga Platoni në shkrimet e tij që kanë mbërritur deri tek ne, në të dyja rastet Sokrati rrëzoi akuzat pjesë pas pjesë: “Nëse është e vërtetë që unë vazhdoj të korruptoj të rinjtë [...] do të duhej të ishin paraqitur këtu për të më akuzuar dhe për t’u hakmarrë [...], ndërsa ju, athinas, do të gjeni të kundërtën; do të gjeni që ata janë të gjithë gati të më ndihmojnë, e jo të më dëmtojnë, gjë që do të më kishte ndodhur nëse do t’i kisha korruptuar siç pretendojnë Meleti dhe Aniti.” Pastaj, për sa i përket demonëve për të cilët ai fliste, që ishin të ashtuquajtur “bij bastardë të perëndive”, ai shtonte: “kush do të guxonte të thoshte se janë bij perëndish, dhe jo vetë perëndi?”

VDEKJE E QETË


Duke iu përgjigjur kundërshtarëve të tij dhe drejtuar direkt bashkëqytetarëve, Sokrati këmbënguli se nuk kishte dhënë asnjëherë mësim për para, por se ia kishte kushtuar jetën kërkimit të së vërtetës. Roli i tij kishte qenë ai i zgjimit të ndërgjegjes qytetare të athinasve, edhe me koston e të qenit i bezdisshëm, si një mizë që pickon vazhdimisht një kalë të madh dhe dembel.

Vetëmbrojtja e Sokratit e ndau jurinë në dysh, por ajo në fund e shpalli filozofin fajtor me një diferencë prej vetëm 30 votash. Ndryshe nga çdo pritshmëri, në momentin kur duhej të propozohej një dënim më i butë nga vetë i akuzuari – si internimi – Sokrati papritur ngriti më tej tonin, duke riafirmuar pafajësinë e tij dhe duke propozuar që të mbahej nga shteti në Pritane, vendi ku priteshin dhe nderoheshin qytetarët më të mirë të Athinës.

Një lëvizje tronditëse, që nga njëra anë konfirmonte moralin e tij ekstrem, por nga ana tjetër u interpretua si provokim. Rezultati qe tragjik: me 360 vota kundërt 140, ai u dënua me vdekje.

Pjesa tjetër është histori e njohur: një muaj më vonë ai piu kupën fatale, duke refuzuar të arratisesh nga burgu pavarësisht lutjeve të nxënësve të tij dhe duke pranuar vendimin për të mos kundërshtuar ligjet e qytetit.

Një fund tragjik dhe madhështor, që e përjetësoi famën e tij si njeri i drejtë, i përkushtuar deri në fund ndaj shoqërisë dhe i gatshëm të vdiste për koherencën. / bota.al



CHELSEA SHPALLET KAMPIONE E BOTËS

NJU-JORK, 14 KORRIK - Chelsea ka shënuar fitore me rezultat 3-0 ndaj Paris Saint-Germainit (PSG) në finale të Kupës së Botës për Klube. “Blutë e Londrës” e kanë nisur në mënyrë fantastike këtë takim, duke mos treguar aspak frikë ndaj kampionit të Evropës. Të besuarit e Enzo Marsecas e kanë gjetur golin e avantazhit në minutën e 22-të përmes Cole Palmer, i cili ka realizuar një gol të bukur për rezultatin 1-0. Ishte pikërisht Palmer i cili ka shënuar vetëm disa minuta më vonë (30’) për ta dyfishuar epërsinë e londinezëve. Epërsia prej dy golash nuk u ka bërë përshtypje “Bluve të Londrës” të cilët vazhdimisht ishin në kërkim të golit të tretë. Pas disa tentimeve ka ardhur edhe goli i tretë. Sërish vendimtar doli të jetë Palmer, i cili kësaj radhe ishte në rolin e asistuesit. Reprezentuesi anglez ka dhuruar një pasim milimetrik në drejtim të sulmuesit Joao Pedro, i cili me klasë ka shënuar përballë




Donnarummas për rezultatin 3-0. Në pjesën e dytë PSG-ja ka marrë iniciativën, por pa arritur në asnjë rast ta rrezikojë seriozisht portën e gjigantit anglez. Duke marrë parasysh epërsinë e thellë të krijuar pas pjesës së parë, Chelsea ka arritur me plot

sukses ta menaxhojë atë në të dytën. Në ceremoninë e organizuar nga FIFA për ndarjen e medaljeve dhe kupës ka marrë pjesë edhe presidenti amerikan Donald Trump, i cili ka festuar së bashku me lojtarët e Chelseat.

UEFA DELEGON GJYQITARË NGA KOSOVA NË LIGËN E KAMPIONËVE

PRISHTINË, 14 KORRIK - Shtëpia e futbollit evropian, UEFA, ka përzgjedhur gjyqtarë nga Kosova për ta ndarë drejtësinë në ndeshjen e kthimit Zrinjski - Virtus që do të luhet në kuadër të raundit të parë kualifikues të Ligës së Kampionëve. Federata e Futbollit e Kosovës ka njoftuar se gjyqtar kryesor i këtij takimi që do të zhvillohet në Bosnjë-Hercegovinë do të jetë Visar Kastrati. Kastrati do të asistohet nga Besnik Morina e Arbnor Bullatovci, kurse gjyqtar i katërt do të jetë Valon Bajgora. Dardan Çaka do të jetë në VAR, kurse Alban Shala në AVAR në këtë përballje që do të luhet sot (e martë) prej orës 21:00. Ndeshjen e parë të luajtur javën e shkuar në San Marino e ka fituar skuadra e Zrinjskit me rezultatin 2:0.



SHKURT

Javën e ardhshme tërhiqet shorti për Superligën dhe Ligën e Parë

PRISHTINË, 14 KORRIK - Federata e Futbollit e Kosovës (FFK) ka njoftuar se javën e ardhshme do të tërhiqet shorti për sezonin 2025/26 në Superligë dhe Ligën e Parë në futboll. Në fakt, FFK-ja ka njoftuar se më 21 korrik në selinë e saj do të hidhet shorti për sezonin e ri i cili pritet të jetë shumë interesant në të dy kategoritë e para të futbollit të Kosovës. Në njoftim, FFK-ja ka bërë me dije se shorti për Superligë do të tërhiqet prej orës 13:30, kurse ai për Ligën e Parë nga ora 14:00. Sezoni i ri, si në Superligë dhe në Ligën e Parë, nis më 16 gusht. Superliga edhe në sezonin 2025/25 do t'i ketë 10 skuadra, ndërsa Liga e Parë është shndërruar në ligë unike, e cila përbëhet prej 18 skuadrave.



Fisnik Asllani te Hoffenheimi deri në vitin 2029

Hoffenheim, 14 korrik - Sulmuesi i Kombëtares së Kosovës, Fisnik Asllani, edhe zyrtarisht ka vazhduar bashkëpunimin me Hoffenheimin. Ekipi nga Bundesliga ka zyrtarizuar rinovimin e kontratës me Asllanin. Klubi gjerman ka thënë se Asllani ka firmosur kontratë afatgjatë, por mediumet gjermane kanë raportuar se ka rinovuar për tri vjet. Me rinovimin e kontratës Asllani do të jetë pjesë e Hoffenheimit deri në verën e vitit 2029. Asllani këtë verë është kthyer te Hoffenheimi pas huazimit tek Elversbergu në Bundesligën 2, ku sezonin e shkuar ka shkëlqyer me 18 gola. Asllani kishte kontratë me Hoffenheimin deri në vitin 2026 dhe kishte ofertë nga Werder Bremen këtë verë, por ka preferuar qëndrimin tek ekipi i tij. “Jam shumë i lumtur që vazhdoja kontratën me Hoffenheimin. Pas dy huazimeve e kisha ndjenjën se puna me Hoffenheimin ende nuk ka përfunduar”, ka thënë Asllani.



Lumbardh Dellova me kontratë të re te CSKA-ja


SOFJE, 14 KORRIK - Klubi i Superligës së Bullgarisë, CSKA Sofja i ka ofruar kontratë të re mbrojtësit të Kombëtares së Kosovës, Lumbardh Dellova. Te CSKA janë të kënaqur me

paraqitjet e Dellovës dhe po presin përgjigje pozitive prej tij sa i përket kontratës së re. Dellova 26-vjeçar i është bashkuar ekipit bullgar vitin e shkuar nga Ballkani dhe

kontrata aktuale i skadon në verën e vitit 2027. Në 36 ndeshje të luajtura për CSKA Sofjen në të gjitha garat, Dellova ka shënuar dy gola dhe ka bërë po aq asistime. 26-

vjeçari ka debutuar në mars të vitit 2022 me Kombëtaren e Kosovës, ndërsa deri më tani ka regjistruar 15 paraqitje dhe ka shënuar dy gola për “Dardanët”.





F2/BNJ



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE " PASTRIMI" SH.A

Bazuar në Ligjin e Punës Nr. 03/L-212, konkretisht Neni 8, në Rregulloren nr. 07/2024 për Marrëdhënien e Punës në KRM "Pastrimi" Sh.A. konkretisht Nenin 11 dhe 12, në Rregulloren Nr. 01/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në KRM "Pastrimi" SH.A, në Vendimin e datës 10.07.2025 me numër të protokollit 02/01/516 të Kryeshefit Ekzekutiv të KRM "Pastrimi" SH.A, shpallë këtë:

KONKURS PUBLIK
Për plotësimin e vendit të punës

Titulli i vendit të Punës: **Shofer i Kategorisë C dhe C1**
Nr. i kërkuar: **Dy (2) pozita në NJO Lipjan, në KRM "Pastrimi" Sh.A.**
Numri i referencës: **NJOL/KJ-19/2025**
Koeficienti/Paga mujore: **XI**
Kohëzgjatja e kontratës së punës: **Me kohë të pa caktuar**
Periudha provuese: **3 muaj**

1. Detvrat dhe Përgjegjësitë:

- 1.1 Nget automjetin sipas urdhërësës së punës në rajonin që i është përcaktuar nga udhëheqësi;
- 1.2 Është përgjegjës për udhëtoje nëpër rrugët dhe zona të caktuara për të mbledhur mbeturinat në mjediset e tyre të vendosura sipas planifikimit të kompanisë;
- 1.3 Kontrollon mjedisin për të identifikuar mbeturinat që duhet të merren dhe për të siguruar që puna bëhet sipas rregullave të shëndetit dhe sigurisë duke mos penguar komunikacionin;
- 1.4 Në bashkëpunim me udhëheqësin planifikon rrugët më të efektshme për të mbledhur mbeturinat nga zona që i është caktuar për të minimizuar humbjen e kohës dhe ruajtjen koston e udhëtimit;
- 1.5 Është përgjegjës për të siguruar që automjeti të jetë i sigurt dhe i gatshëm për përdorim përfshirë në kontrollin e nivelit të karburantit, kontrollin e presionit të gomave dhe kujdesin e përgjithshëm të automjetit.
- 1.6 Shoferi duhet të sigurojë që mbeturinat e cilësuar si shpërthyes të vendosen dhe të transportohen me kujdes të veçantë, duke zbatuar rregulloret mbi mbeturinat e rrezikshme;
- 1.7 Raporton çdo situatë të jashtëzakonshme që ndodh gjatë detyrës përfshirë emergjencat, dëmtime të automjetit ose shkelje të sigurisë;
- 1.8 Kujdeset dhe i respekton rregullat e komunikacionit rrugor;
- 1.9 Mbanë regjistrë të përgjegjëshmërisë, në përputhje me rregulloret dhe politikat e kompanisë.
- 1.10 Kryen edhe punë tjera sipas kërkesës së udhëheqësit të drejtpërdrejtë;
- 1.11 Për punën e tij i përgjigjet Menaxherit të Njësisë Operative.

2. Kriteret e përgjithshme për pranim në detvrë:

- ✓ Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës,
- ✓ Të zotërojë të paktën njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- ✓ Të jetë e/i aftë për të kryer detyrën përkatëse;
- ✓ Të mos jetë e/i dënuar për kryerjen e një veprës penale;
- ✓ Të mos ketë në fuqi masë disiplinore për shkelje të rëndë në institucion publik;
- ✓ Të ketë arsimin, përvojën e punës profesionale dhe/apo aftësitë e kërkuara për pozitën
- ✓ Të kalojë me sukses procedurat e pranimi të përcaktuara në ligj.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- ✓ Arsimimi i kërkuar: Shkollim i Mesme
- ✓ Përvoja e punës e kërkuar: 2 vite përvojë pune

4. Njohuritë, aftësitë dhe cilësitë e kërkuara në procedurën e rekrutimit

- ✓ Aftësi të arsyetimit logjik dhe analizës;
- ✓ Aftësi komunikimi dhe ndikim personal, përfshirë aftësi për të përfaqësuar.
- ✓ Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- ✓ Aftësi për të bërë gjykime profesionale të pavarura dhe për të ushtruar diskrecion mbi çështjet dhe për të dhënë një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin dhe zbatimin e politikave;
- ✓ Njohuri të gjera të fushës, të metodave kërkimore, që ndihmojnë në përgatitjen e raporteve bazike ose analitike;

5. Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre

Aplikacioni i plotësuar dhe nënshkruar nga kandidati	✓
CV - në	✓
Kopje të diplomave të dhëna nga Institucionet Arsimore	✓
Kopje të dëshmisë së punësimit (Trusti Pensional, Vërtetimi, apo Kontratë të Punës)	✓
Kopje të dëshmisë së trajnimeve dhe kurseve (e dëshirueshme)	✓
Kopje të vlerësimeve të punës për dy vitet e fundit (e dëshirueshme)	✓
Kopjen e letërnjoftimit/pasaportës/certifikatës së shtetësisë së Republikës së Kosovës	✓
Vërtetimin që nuk është i dënuar për kryerjen e një veprës penale, JO më të vjetër se 3 muaj	✓

6. Mënyra e aplikimit në konkurs dhe dorëzimi aplikacionit:

- 6.1 Tërheqja e formularëve zyrtarë bëhet:
- * duke e shkarkuar nga faqja zyrtare në rrjetin social Facebook: Kompania Rajonale e Mbeturinave "Pastrimi" Sh.A.
 - * në Zyrat e Burimeve Njerëzore në KRM " Pastrimi" SH.A.

- 6.2 Dorëzimi i aplikacionit:
- * bëhet vetëm në mënyrë elektronike nëpërmjet adresës: punesimi.krmpastrimi@gmail.com dhe
 - * në rastet e konkurseve të brendshme, të pozitave teknike mund të bëhet edhe në formë fizike.

7. Data dhe ora e saktë e mbvlljes së Konkursit Publik:

Konkursi Publik zgjatë 15 ditë nga data 15/07/2025 deri me datën 29/07/2025

Koha e fundit e pranimi të aplikimeve është ora 16:00.

Të gjitha aplikimet që arrijnë pas afatit të fundit nuk do të merren parasysh.

8. Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit.

Vlerësimi i kandidatëve bëhet në bazë të CV-së, testit shkrim dhe me intervistim (testi me gojë).

- ✓ CV-ja e kandidatit vlerësohet deri në dhjetë (30) pikë;
- ✓ Intervista (testi me goje) vlerësohet deri në tridhjetë (70) pikë.

Procedura e vlerësimit përmban gjithsejtë njëqind (100) pikë, ku kalueshmëria është arritja e së paku pesëdhjetë e pesë (55) pikëve nga të gjitha fazat e Konkursit Publik.

9. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

Të gjithë kandidatët do të njoftohen nëpërmjet komunikimin elektronit dhe individualisht.

10. Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;

Faza e testit me shkrim deri 10 ditë pas fazës së verifikimit,

Faza e Intervistës deri 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim.

Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistë.

Vërejtje: Dokumentet e pa kompletuara, të pa skanuara si dhe ato që arrijnë pas skadimit të afatit të konkursit nuk do të shqyrtohen.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Florjana Berisha nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e klasës; 10,11,12 të lëshuar nga Gjimnazi "Hajdar Dushi".
- Bleta Babuni nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e klasës: 10,11,12 dhe diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Petrit Mushkolaj shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm të Mjekësisë "Hysni Zajmi", Gjakovë.
- Butrinit Sharani nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi", Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar,
- Lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë nume të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroj i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

F2/BNJ



REGIONALNO PREDUZEĆE ZA OTPAD "PASTRIMI" A.D.

Na osnovu Zakona o radu br. 03 / L-212, posebno člana 8, u Uredbi br. 07/2024 o radnom odnosu u kompaniji RPO "PASTRIMI" a.d. konkretno članovi 11 i 12, u Uredbi br. 01/2024 o unutrašnjoj organizaciji i sistematizaciji radnih mesta u RPO "PASTRIMI" SH. A, u Odluci od 10.07.2025. godine sa brojem protokola 02/01/516 izvršnog direktora RPO-a "PASTRIMI" A.D., objavite ovo:

JAVNI KONKURS
Za popunjavanje posla

Naziv posla: Vozač Kategorija C i C1
Ne. Obavezno: Dve (2) pozicije u NJO Lipjan, u RPO "Pastrimi" Sh.A.
Referentni broj: NJOL / KJ-19 / 2025
Koeficijent / Mesečna plata: XI
Trajanje ugovora o radu: Na neodređeno vreme
Probni rok: 3 meseca

1. Dužnosti i odgovornosti:

- 1.1 Vozi vozilo u skladu sa radnim nalogom u regionu koji mu je dodelio voda;
- 1.2 Odgovoran je za putovanje ulicama i određenim područjima za prikupljanje smeća u njihovim prostorijama koje se nalaze u skladu sa planiranjem kompanije;
- 1.3 Proverite životnu sredinu kako biste identifikovali otpad koji treba uzeti i osigurali da se posao obavlja u skladu sa zdravstvenim i bezbednosnim pravilima koja ne ometaju saobraćaj;
- 1.4 U saradnji sa liderom, planira najefikasnije rute za prikupljanje smeća iz područja koje mu je dodeljeno kako bi se smanjio gubitak vremena i sačuvali troškovi putovanja;
- 1.5 Odgovoran je za obezbeđivanje da je vozilo bezbedno i spremno za upotrebu, uključujući kontrolu nivoa goriva, kontrolu pritiska u gumama i opštu negu vozila.
- 1.6 Vozač mora da obezbedi da se otpad klasifikovan kao eksploziv stavlja i transportuje sa posebnom pažnjom, u skladu sa propisima o opasnom otpadu;
- 1.7 Izveštava o svim vanrednim situacijama koje se dešavaju na dužnosti, uključujući hitne slučajeve, oštećenje vozila ili kršenja bezbednosti;
- 1.8 Brine i poštuje pravila drumskog saobraćaja;
- 1.9 Održava evidenciju odgovornosti, u skladu sa propisima i politikama kompanije.
- 1.10 Obavlja i druge poslove na zahtev direktnog vođe;
- 1.11 Za svoj rad odgovoran je rukovodiocu Operativne jedinice.

2. Opšti kriterijumi za prijem na funkciju:

- ✓ biti državljanin Republike Kosovo,
- ✓ da poseduju najmanje jedan od službenih jezika, u skladu sa Zakonom o jezicima;
- ✓ Biti e/sposoban za obavljanje relevantne dužnosti;
- ✓ Da ne bude osuđen za izvršenje krivičnog dela;
